

Njoftim Për Shtyp Datë 20 Korrik 2022



20 July, 2022 by **KLJGJ** in **NJOFTIME PËR SHTYP**

Sot, në datën 20.07.2022, Këshilli i Lartë Gjyqësor zhvilloi mbledhjen plenare të radhës, në të cilën shqyrtoi çështjet si vijon: Në përfundim të procedurave të verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidatëve për magjistratë, profili gjyqtar, të diplomuar në Shkollën e Magjistraturës për vitin akademik 2021-2022, Këshilli vendosi kualifikimin e 23 kandidatëve dhe në vijim emërimin e tyre si gjyqtarë.

Gjithashtu, Këshilli vendosi pezullimin e procedurës së verifikimit të pasurisë dhe figurës për një nga kandidatët.